



REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT
AGJENCIA PËR SHËRBIME MEDIATIKE AUDIO DHE AUDIOVIZUELE
PA1 Nr.03-261
18.08.2023
Shkup

Në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 20 dhe neni 23 paragrafi (1) nënparagrafi 1 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele ("Gazeta Zyrtare e Republikës Maqedonia" nr.184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 42/20, 77/21 dhe 154/23), dhe në lidhje me nenin 64 paragrafi (1) të Ligjit të njëjtë, pika 5 dhe pika 14 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrjen e masës (Tekst i pastruar) ark.nr.01-4139/1 datë 7.11.2022, Raporti me shkrim për mbikëqyrjen e kryer programore ark.nr.10-2999/1 datë 31.7.2023 dhe Konkluzioni ar.nr.02-3170/3 datë 17.8.2023, Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, në seancën e 27-të, mbajtur më 16.8.2023 miratoi si vijon:

Aktvendim
për ndërmarrje të masës - paralajmërim publik

1. PUBLIKISHT PARALAJMËROHET Shoqëria Tregtare Radiodifuzive (SHTR) TV K&M KISS&MENADA SHPKNJP Tetovë, për shkeljen e kryer të nenit 64 paragrafi (1) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (LSHMAAV), për mënyrën që në shërbimin programor televiziv të transmetuesit, të transmetuar më 6 korrik 2023, në një emision nuk është ofruar përkthim në gjuhën maqedonase, dhe atë në emisionin "Leskovačka roshtilijada 2014" disa nga deklaratat e bashkëbiseduesve fillimisht janë transmetuar në gjuhën serbe, pa ofruar përkthim në gjuhën maqedonase.

Shkelja nga paragrafi (1) i kësaj pike është përcaktuar në Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer programoreme nr.ark.10-2999/1 datë 31.7.2023, e cila është pjesë përbërëse e këtij aktvendimi si Shtojca nr. 1.

2. URDHËROHET SHTR TV K&M KISS&MENADA SHPKNJP Tetovë që në afat prej 10 (dhjetë) ditësh nga dita e pranimit të këtij aktvendimi, të harmonizojë punën e tij me dispozitat e LSHMAAV.

3. Pas skadimit të afatit të përcaktuar në pikën 2 të këtij aktvendimi, të kryhet mbikëqyrje kontrolli, për të përcaktuar nëse subjekti i mbikëqyrjes, i përcaktuar në pikën 1 të këtij aktvendimi, ka vepruar sipas aktvendimit.

4. Ky Vendim është përfundimtar dhe dita e miratimit të tij llogaritet (konsiderohet) dita e çertifikimit në Arkivin e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (Agjencia).

A r s y e t i m

Agjencia në bazë të nenit 28 të LSHMAAV është kompetente për të kryer mbikëqyrje programore (monitorimin) të programeve të transmetuesve dhe ofruesve të shërbimeve mediatike audiovizuale sipas kërkesës, si dhe të paketave programore që ritransmetohen nga operatorët e rrjeteve publike të komunikimit elektronik nga aspekti i respektimit të dispozitave nga ligji i cituar, lejeve, certifikatat e dhëna për regjistrim, aktet nënligjore dhe aktet tjera të miratuara nga Agjencia.

Në pajtim me nenin 23 paragrafi (1) nënparagrafi 1 të LSHMAAV, Këshilli i Agjencisë ndërmerr masë - aktvendim për vërejtje publike në pajtim me këtë ligj, në rastet kur është kryer shkelje e dispozitave të LSHMAAV dhe akteve nënligjore miratuar në bazë të ligjit të njëjtë, si dhe të kushtvet dhe detyrimeve të përcaktuara me lejen dhe aktet e tjera të Agjencisë.

Në pajtim me nenin 64 paragrafi (1) të LSHMAAV, transmetuesit janë të obliguar që programin ta transmetojnë në gjuhën maqedonase dhe alfabetin cirilik, dhe në rastet kur programi është i dedikuar për komunitetin që nuk është shumicë, në gjuhën dhe shkrimin e atij komuniteti.

Në kuadër të kompetencave të veta ligjore, Agjencia nëpërmjet Sektorit për çështje programore, më 31 korrik 2023 ka kryer mbikëqyrje të rregullt programore (monitorim) të shërbimit programor televiziv të SHTR TV K& M KISS&MENADA SHPKNJP Tetovë transmetuar më 6 korrik 2023, në nivel rajonal, në të cilin ka konstatuar shkelje të nenit 64 paragrafi (1) të LSHMAAV.

Gjegjësisht, me mbikëqyrjen e rregullt është konstatuar se më datë 6.7.2023, në shërbimin programor televiziv të SHTR K&M KISS&MENADA SHPKNJP Tetovë, në emisionin " Leskovaçka roshtilijada 2014" disa nga deklaratat e bashkëbiseduesve fillimisht (burimisht) janë transmetuar në gjuhën serbe, pa ofruar përkthim në gjuhën maqedonase.

Shkelja nga pika 1 e këtij aktvendimi është përcaktuar në Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore me nr.ark.10-2999/1 datë 31.7.2023 e cila është pjesë përbërëse e këtij aktvendimi si Shtojca nr. 1.

Në bazë të nenit 23 paragrafi (3) të LSHMAAV, Këshilli i Agjencisë drejtuar SHTR TV K&M KISS&MENADA SHPKNJP Tetovë, më 1.8.2023, ka dërguar Shkresë me nr.ark.10-2999/2 datë 1.8.2023, me të cilin i dorëzoi Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer programore me nr.ark.10-2999 /1 datë 31.7.2023, me qëllim që në afat prej 7 (shtatë) ditë pune nga dita e pranimi të shkresës, drejtuar Këshillit të Agjencisë të dorëzon deklaratë me shkrim për shkeljen e kryer të dispozitave të LSHMAAV. Shkresa u pranua në mënyrë të rregullt më 4.8.2023. Në afatin e paraparë SHTR TV K&M KISS&MENADA SHPKNJP Tetovë nuk u deklaruar për shkeljen e kryer nga LSHMAAV. Në seancën e mbajtur më 16.8.2023, Këshilli i Agjencisë e shqyrtoi lëndën raport me shkrim dhe konstatoi se ndaj SHTR TV K&M KISS&MENADA SHPKNJP Tetovë t'i shqiptohet masë – vërejtje publike .

Si rezultat i sa më sipër, bazuar në nenin 18 paragrafi (1) nënparagrafi 20 dhe neni 23 paragrafi (1) nënparagrafi 1 të LSHMAAV, dhe në lidhje me nenin 64 paragrafi (1) nga Ligji i njëjtë, pika 5 dhe pika 14 e Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas vendimeve të Agjencisë për marrjen e masave (teksti i pastruar), raporti me shkrim për mbikëqyrjen e kryer programore me nr.ark.10-2999/1 datë 31.7.2023 dhe Konkluzionin me nr.ark.02-3170/ 3 datë 17.8.2023 për konstatim të mosrespektim të dispozitave të LSHMAAV, përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, Këshilli i Agjencisë së seancën mbajtur me 16.8. 2023, miratoi Vendim me të cilën publikisht paralajmëron SHTR TV K&M KISS&MENADA SHPKNJP Tetovë, dhe urdhërohet që në afat prej 10 (dhjetë) ditësh nga dita e pranimi të Vendimit, të harmonizojë punën e saj me dispozitat e LSHMAAV. Pas skadimit të afatit të përcaktuar në pikën 2 të këtij vendimi, të kryehet mbikëqyrje kontrolli, për të përcaktuar nëse subjekti i mbikëqyrjes, i përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, ka vepruar sipas vendimit.

Në bazë të nenit 24 të LSHMAAV, ky Vendim është përfundimtar dhe kundër këtij transmetuesi ka të drejtë padie për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për ngritjen e kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimi të aktvendimit.

Bazuar në sa më sipër u mor vendim si në dispozitiv.

Shtojca (1):

- 1) Raport me shkrim për mbikëqyrjen e kryer programore ark.nr.10-2999/1 datë 31.7.2023.

**Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuale
Kryetari i Këshillit,
Lazo PETRUSHEVSKI, d.v.**

Këshillë juridike: Kundër këtij aktvendimi transmetuesi ka të drejtë padie për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për ngritjen e kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimi të aktvendimit.